



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 345/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Shtërpce, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Shtërpce, për shkak të vendosjes së posterave brenda hapësirave publike për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Shtërpce kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1250(njëmijë e dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i me datën 25. 10. 2013 ka pranuar një ankesë nga LVV-ja, në të cilën theksohet se me datën 24 tetor 2013 në hapësirat e sallës së kulturës në fshatin Drekok të komunës së Shtërpçës gjatë mbajtjes së trajnimit të anëtarëve të vendvotimeve të nacionalitetit serb në sallën ku po mbahej ky trajnim në ballë të sallës kanë qenë të ngjitura posterët dhe pamfletet e PDK-së. Andaj me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës anëtari i KKZ-së nga subjekti politik LVV Emrush Azizi ka kërkuar që të hiqen posterat dhe materiali tjetër nga vendi ku ishte i vendosur anëtari i KKZ-së nga rradhët e PDK-së ka refuzuar një gjë të tillë.

Me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik PDK ka shkelur nenin 33 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotografit nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, në pajtim me nenin 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, datën 26.10.2013 informoi subjektin politik PDK për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 28.10.2013, ora 10:00.

Me datën 28.10.2013 sipas afatit të paraparë PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së janë të pabaza lidhur me shkeljen e dispozitave ligjore të LZP-së pasi që sipas të dhënave nga tereni salla e shtëpisë së kulturës në fshatin Drekok ka qenë e dedikuar për një tubim elektorale të PDK-së dhe se trajnimi i KKZ-së nuk ka qenë i paraparë të mbahet në këtë vend dhe se as që ka qenë i paralajmëruar. Në përgjigje në ankesë theksohet se për këtë paraprakisht janë njoftuar anëtarët e KKZ-së se në sallë ka simbole të PDK-së dhe se përkundër kësaj salla është liruar nga simbolet e PDK-së gjë për të cilën dëshmohet edhe me fotot e bëra.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se posterat dhe pamfletet e subjektit politik PDK-së, ishin të vendosura brenda hapësirave të sallës së kulturës aty ku mbahej trajnimi i organizuar nga KKZ-ja në Shtërpce, veprime të cilat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, për këtë mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti politik PDK ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe rregullat zgjedhore. Andaj vendosja e posterave dhe e pamfleteve të saja brenda hapësirave publike gjatë kohës kur po mbahej trajnimi i KKZ-së e bënë përgjegjës këtë subjekt politik. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori parasysh faktin se PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime konkrete duke i larguar menjëherë posterat dhe pamfletin e PDK-së nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstaton se subjekti politik PDK-së ka shkelur nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakateve, posterave apo të slloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike.

Andaj meqenëse posterat dhe pamfletin e PDK-së kanë qenë të vendosura brenda hapësirave publike gjatë kohës sa zhvillohej trajnimi i KKZ-së, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të këtij subjekti që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e tjera të ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 345/2013 më datën 31.10.2013.



Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi

Këshillë juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*